REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 44/17
Datë/Datum. 10.03.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH Nr. 44/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: z.Nuhi Paçarizi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE ankues "NTSH BESI" – Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve të MKRS-së", Lot 1 dhe Lot 2, me nr prok:"207/16/015/221", iniciuar nga AK–/Ministria e Kulturës Rinis dhe Sportit/ më datën 01.03.2017 mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet,** si e bazuar ankesa e OE NTSH "BESI" – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve të MKRS-së", Lot 1 dhe Lot 2, me nr prok:"207/16/015/221", iniciuar nga autoriteti kontraktues / Ministria e Kulturës Rinis dhe Sportit /.

II. **Anulohet,** vendimi i AK-së /Ministria e Kulturës Rinis dhe Sportit/, për dhënie të kontratës dhe **anulohet në tërësi** aktiviteti i prokurimit me titull "Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve të MKRS-së", Lot 1 dhe Lot 2, me nr prok:"207/16/015/221", ndërsa autoriteti kontraktues, nëse edhe më tutje ka interes për këtë aktivitet të prokurimit mund ta ritenderojë.

III. Autoriteti kontraktues në afat prej 10 ditësh, duhet ta informojë me shkrim Panelin shqyrtues, për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe palët tjera në procedurë.

IV. Operatorit ekonomik ankues OE "NTSH BESI" – Prishtinë, konform nenit 118.3 të LPP-së i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës në shumë e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, pasi që ankesa është aprovuar e bazuar.

V. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 36 pika 5 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:19.08.2016.

Hapja e ofertave është bërë me dt: 05. 09. 2016, ku kanë marr pjesë gjashtë operatorë ekonomik.

Letra standarde për tenderuesin e pasuksesshëm është bërë me datën 18.01.2017

Njoftimi për dhënie të kontratës është bërë me dt: 20.01.2017, e ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: "DPZ SUZUKI"-Fushë Kosovë.

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës, operatori ekonomik "NTSH BESI" – Prishtinë, me dt:24.01.2017, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt:31.01.2017, autoriteti kontraktues ka marr vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "NTSH BESI" – Prishtinë.

Operatori ekonomik "NTSH BESI" – Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, më 10 shkurt 2017 me nr. 44/17, kundër njoftimit për dhënie të kontratës me titull: "Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve të MKRS-së", Lot 1 dhe Lot 2, me nr prok:"207/16/015/221", duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitës së LPP-së nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, siç janë:

- Neni 1 i LPP-së –Qëllimi i Ligjit
- Neni 59 i LPP-së –Ekzaminimi, vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- Neni 61- Rregullat për tender jo normalisht të ulët
-

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së, ka autorizuar ekspertin e OSHP-së, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues përmes raportit të datës 22 shkurt 2017, vlerëson se pretendimet ankimore janë të qëndrueshme dhe i rekomandon Autoritetit Kontraktues që të anuloj aktivitetin e prokurimit pasi që lista e çmimeve nuk është e harmonizuar me kërkesat e AK-së.

Operatori ekonomik ankues "NTSH BESI" - Prishtinë, me datë: 23 shkurt 2017, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues me datë: 27 shkurt 2017, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 01.03.2017, e cila është mbajtur pa praninë e palëve të përfshira në procedurë konform nenit 28 pika 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së, kanë qenë prezent kryetari i panelit shqyrtues, eksperti shqyrtues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë eksperti shqyrtues ka deklaruar: "Në bazë të pretendimeve ankimore, në ekspertizë kam deklaruar se është e pamundur kalkulimi i çmimeve ku një OE ofron çmime për një pozicion që realisht automjetet nuk e posedojnë atë pjesë. Si shembull, automjetet e tipit "Dizel" nuk përmbajnë boshpumpa, kjo nënkupton se ky pozicion duhet të jetë me "Zero" (0). Njëkohësisht në fund të paramasës së vet AK-ja ka dhënë vërejtje se tek automjetet që nuk përmbajnë pjesët çmimi duhet të jetë zero. Nëse shikojmë ofertën e OE të rekomanduar për kontratë shohim që në pozicionet ku është dashtë të jetë zero ka ofruar çmime të ndryshme për njësi. Ndërsa OE ankues në pozicionet ku mendohet që automjetet nuk përmbajnë ato pjesë, çmimi është me zero. Realisht është e vështirë të bëhet poentimi në bazë të grupimit apo peshës së çmimit kur njëri OE ka dhënë çmim për një pozicion që nuk ekziston ndërsa OE tjetër ka ofruar çmimin zero. OE ankues ka paramasë në disa pozicione me njësi zero, ndërsa OE i rekomanduar të gjitha pozicionet i ka me njësi "një", e që në realitet disa prej këtyre pozicioneve do duhej të ishin me zero, pasi që automjetet nuk i posedojnë ato pjesë. Në bazë të kësaj nuk mund të kemi përllogaritje të saktë të peshës së çmimeve të dhëna. Andaj i rekomandoj panelit shqyrtues që lënda të anulohet në tërësi".

Paneli shqyrtues, pas analizimit të të gjitha shkresave të lëndës fakteve dhe provave të prezantuara, prezantimeve në seancën për shqyrtim kryesor, ka konstatuar, se AK-ja nuk ju ka përmbajtur nenit 59 të LPP-së, për faktin se ka vlerësime kontradiktore mes raportit standard për rivlerësim, ku OE "Besi" trajtohet i përgjegjshëm në aspektin administrativ, teknik dhe financiar ku poentohet në bazë të peshës së çmimeve çka do të thotë sipas vlerësimeve të anëtarëve të komisionit vlerësues nuk kemi të bëjmë me ofertë të papërgjegjshme, ndërsa në anën tjetër në vendim për rishqyrtim të ankesës OE "BESI" trajtohet i pa përgjegjshëm, pra kemi të bëjmë me vlerësim kundërthënës në mes komisionit vlerësues dhe zyrtarit të lartë të Prokurimit.

Paneli shqyrtues konstaton se autoriteti kontraktues listën e çmimeve nuk e ka harmonizuar në përputhje me natyrën e prokurimit për faktin se ka kërkuar që të ofrohet çmim për njësi për pjesët të cilat nuk i posedojnë disa automjete. Prandaj nuk mund të kërkohet çmim për pjesë që nuk posedon automjeti p.sh. si mund të kërkohet për automjetet me benzinë boshpump apo dizne. Prandaj nuk mund të jetë njësia 1 për pjesët që nuk i përmban automjeti dhe si e tillë normalisht që nuk mund të kërkohet që të ofrohet edhe çmim për këtë njësi. Paneli shqyrtues konstaton se dosja e tenderit nuk është përgatitur si duhet dhe në harmoni me natyrën dhe qëllimin e prokurimit për faktin se nuk mund të ofertohet për pjesë të cilat nuk ekzistojnë dhe të cilat nuk kanë për tu mirëmbajtur apo servisuar asnjëherë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Nuhi PAÇARIZI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – "MKRS"

1x1 OE – "NTSH BESI"-Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.